



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e V-të (pestë) -e jashtëzakonshme, mandati VIII-të, e mbajtur më 26 shkurt 2026.

Mbledhja filloi në orën 10:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Isak Shabani Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV: *Adelinë Stublla; Artrit Mulliqi; Fatri Zhitija; Kasib Bashota; Florent Hasani; Valdet Kamerolli; Arbrim Konushevc; Flandra Kadriu; Luljeta Muçolli-Azemi; Vlora Jashanica; Haki Rudari; Abedin Zeka; Qëndresë Hajrizi; Ardi Hasani, kurse mungoi Avni Islami.*

Nga LDK: *Alisa Jetullahu; Enis Dërvisholli; Besim Latifi; Valdet Restelica; Blerta Azemi-Berisha; Valon Demolli; Ekrem Rrahmani; Gresa Qosa-Maqastena; Arben Xhemajli; Arnisa Sylejmani; Isak Ejupi, kurse munguan Enis Shabani; Ermal Osmani;*

Nga PDK: *Isak Shabani-Kryesues i Kuvendit; Lulzim Pollomi; Mimoza Abdullahu; Rinesa Goxhufi,*

Nga GUXO: *Demokrat Hodolli.*

Nga Unioni i Blakçorve: *Gentrit Arifi.*

Nga AAK: *Baki Feta.*

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, z.Fahri Restelica Nënkryetar i Komunës, U.D. drejtorët/shat e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Arbnorë Uka Osmani-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).

Të pranishëm ishin edhe, përfaqësues media lokale (TV Llapi), përfaqësues të KFOR; dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, theksoi, pas verifikimit të pjesëmarrësve në listën e nënshkrimeve dhe në përputhje me evidencën zyrtare konstatoj se për momentin 32 anëtar/e të Kuvendit janë të pranishëm andaj edhe mund të konstatohet se ka kuorum dhe mund të vazhdohet me punë dhe vendimmarrje, ndërsa mungojnë Avni Islami, Enis Shabani dhe Ermal Osmani.

Ftesa dhe materialet e kësaj mbledhje ju janë shpërndarë me kohë dhe në pajtim me Rregulloren e punës së Kuvendit, atëherë shpall të hapur këtë mbledhje të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Meqë mbledhja është e jashtëzakonshme dhe nuk mund të plotësohet apo ndryshohet rendi i ditës andaj do ta hedhja në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur dje më 25.02.2026.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 32 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin të pranishëm, miratohet rendi i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, duke përfshirë edhe Konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 25.02.2026.

1. Propozim Vendimi për përfaqësimin e Komunës së Podujevës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ne dje kemi mbajtur edhe mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe në mënyrë unanime jemi dakorduar për mënyrën dhe formën e përbërjes së anëtarëve që do të prezantohen në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës - AKK, propozim i cili ka rrjedhë nga shefi i Grupit të LVV z.Haki Rudari, prandaj e hapi diskutimin dhe lus që nëse ka mundësi edhe njëherë të na prezantohet formula si propozim që ishte nga zotëri Rudari.

z.Haki Rudari, theksoi, ne e kemi një propozim vendim i cili është sjellë në Kuvend në mënyrë që Komuna jonë të përfaqësohet në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, obligim ky i Komunave i cili del edhe në bazë të Statutit i AKK-së ku në nenin ndër të tjera thuhet që Kuvendet Komunale i delegojnë përfaqësuesit e tyre në bazë të numrit të asambleistëve nëpër Kuvendet Komunale dhe në këtë rast në çdo asambleistë kalon një përfaqësues ose delegat e që në rastin tonë apo në Komunën tonë i bie që nga 35 asambleistë ose 3.5 ose thënë ndryshe ne kemi të drejtë t'i delegojmë 4 këshilltarë në Kuvendin e AKK-së, por në të njëjtën kohë duke u bazuar në Statutin e AKK-së të cilin e posedoj këtu sepse kam qenë delegat edhe më parë aty parashihet edhe përfaqësimi i Partive politike të Kuvendeve komunale, jo vetëm këtu por kudo që janë Kuvendet Komunale e kanë përqindjen e vetë të marrjes zyrtarisht, dhe unë edhe dje në KPF e thash që ajo përqindje nuk ndryshon për asnjë subjekt politik, mund të ketë largime, ardhje-shkuarje të këshilltarëve të Kuvendit por përqindja e Partive politike në Kuvendin mbetet në këtë mandat ashtu qysh e kemi edhe pse natyrisht që secili subjekt politik ka dëshirë të ketë përqindje sa më të madhe për vete por ne duhet të punojmë dhe duhet mësuar të punojmë nga aspekti ligjor dhe në të njëjtën kohë krejt në fund është vota e cila e përcakton çdo vendim i cili merret nëpër Kuvende Komunale, prandaj ashtu siç e ceku edhe Kryesuesi i Kuvendit unë dje në KPF e kam prezantuar si propozim formulën e përbërjes por meqë në atë Komitet jemi vetëm 9 anëtarë kurse këtu në Kuvend jemi 35 anëtarëve dua të përsërisë sërish propozimin tim që Kuvendi i Komunës së Podujevës në Kuvendin e AKK-së të përfaqësohet me 2 anëtar/e nga LVV, anëtar nga LDK dhe në të njëjtën kohë t'i jetë edhe Kryesuesi i Kuvendit për arsye se parashihet që të formohet edhe kolegji i Kryesuesve të Kuvendeve në nivel të Komunave të Kosovës, andaj mungesa e tij mendoj se nuk na bën nderë, kështu që kam propozuar formulën e cekur.

z.Besim Latifi, theksoi, unë e kam pranuar materialin përkatës dhe e kam parë edhe Shkresën e dërguar nga AKK e cila shumë qartë thotë se përfaqësimi i Komunave në këtë Asociacion bëhet në proporcion me numrin e votave që ka partia në Kuvend. Unë o ashtu lexova edhe konstatimet e rekomanduara nga KPF dhe besoj se është bërë një gabim aty gjatë kalkulimit sepse shumë e qartë është shkresa e AKK-së andaj mendoj se duhet t'i përmbahemi kësaj shkrese.

Unë e kuptoj që t'i (i drejtohet Kryesuesi të Kuvendit) duhet të jesh pjesë e kuvendit të Asociacionit, atëherë si koalicion që jeni merreni vendin e juaj por nuk është në rregull t'i merrni vendet të cilat i takojnë partive tjera. E them këtë sepse në bazë të kalkulimit matematikor e pash që përfaqësimi duhet të jetë 2 / 2, mirëpo meqë ka kaluar në KPF ajo formulë dhe që ju po e shihni të arsyeshme ashtu atëherë nuk është kurrfarë telashe.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, për që u votu në Komitet ne e dim që ai Komitet jep veç rekomandime për me i pru në Kuvend, këtu është vendi për t'i debatuar dhe për me i sqaruar gjërat, kështu që ne kemi votuar për me pru në Kuvend.

Unë edhe dje e potencova që në bazë të formulës na takojnë 2 m 2 sepse nuk mundet shembull një Parti që ka 4 asambleistë me pas gjithë njëjtë si me një Parti që ka 13 asambleistë sepse vet fjala

kur përmende propozicion dihet sa i bie dhe qysh i bie, por nuk jemi për të koçitë punë, nuk është problem i japim propozime, mirëpo nuk e di përse veç neve gjithë po na bie me qenë më pak.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, atëherë mund të vazhdojmë me propozime dhe e hedhi në votim propozimin e shefit të Grupit të LVV-së z.Haki Rudari sipas formulës së cekur ku: 1-Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi; 2-Kryesuesi i Kuvendit në këtë rast unë; 3-dy anëtar/e nga LVV dhe një anëtar/e nga LDK, andaj a pajtoheni të shkohet me këtë përbërje.

Konstatim:

Njëzëri nga 32 anëtarët/et e pranishëm, mbështetet propozimi që përbërja e përfaqësimit në fjalë të jetë si në vijim: Kryetari i Komunës; Kryesuesi i Kuvendit; Dy (2) përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës, nga radhët e LVV; Një (1) përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës, nga radhët e LDK.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, tani meqë për formulën e përbërjes veç u dakordua dhe u mbështet propozimi në fjalë, tani mund të vazhdojmë me propozimet e emrave, mirëpo normale që edhe në këtë përbërje kërkohet përfaqësimi gjinorë kështu që mund t'i jepni emrat e propozuar, përveq Kryetarit të Komunës dhe mua si Kryesues i Kuvendi.

z.Fatri Zhitija, theksoi, në emër të LVV-së propozojmë që përfaqësuesit nga Grupi ynë në AKK të jenë Haki Rudari dhe Luljeta Muqoll Azemi.

z.Besim Latifi, theksoi, në emër të LDK-së e propozojmë Gresa Qosa Maqastena.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, meqë tani i kemi të kompletuara propozimet dhe po ashtu ka edhe përfaqësim gjinorë ashtu siç kërkohet, atëherë e hedh në votim propozim vendimin në fjalë sipas materialit të dërguar si dhe duke përfshirë edhe përbërjen me emrat e propozuar dhe caktuar paraprakisht.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 32 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin të pranishëm, miratohet propozim vendimi për përfaqësimin e Komunës së Podujevës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së si dhe propozimeve të paraqitura, dhe atë me përbërjen si në vijim:

- 1.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës*
- 2.Isak Shabani, anëtar dhe Kryesues i Kuvendi i Komunës (PDK)*
- 3.Haki Rudari, anëtar nga Kuvendi i Komunës (LVV)*
- 4.Luljeta Muçolli Azemi, anëtare nga Kuvendi i Komunës (LVV)*
- 5.Gresa Qosa Maqastena, anëtare nga Kuvendi i Komunës (LDK)*

2. Propozim Vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKS

z.Fahri Restelica, Nënkryetar i Komunës, duke përshëndetur të pranishmit theksoi, meqë është hera e parë e imja që marrë fjalën dhe dal para jush në këtë foltore në një mbledhje të Kuvendit të Komunës, më lejoni që fillimisht t'ju uroj të gjithë juve e pozita e reja dhe për besimin e marrë nga qytetarët, uroj që çdo parashikim dhe çdo pritje e votuesve t'juaj të realizohet me përkushtim dhe përgjegjësi. Qytetarët janë ata nga të cilët uron pushteti dhe në fund atyre i'u takon prandaj përgjegjësia jonë e përbashkët është që t'ju mundësojmë atyre një qasje sa më të madhe në vendimmarrje dhe të punojmë që besimi që jua kanë dhënë të mos i zhgënjoni në mënyrë që të vazhdoni të meritoni mbështetjen e tyre edhe në të ardhmen.

Ju uroj shëndet juve të gjithëve dhe familjeve t'juaja dhe njëkohësisht kërkoj mirëkuptimin edhe nga familjet e juaja për angazhimin he betejat politike që na presin dhe që do të zhvillojmë në të ardhmen duke shpresuar që ato të zhvillohen gjithmonë brenda suazave të respektit dhe me qëllimin e vetëm mirëqenien e qytetarëve dhe asnjëherë përtej saj. Po ashtu shpresoj që kjo vija ndarëse që është në mes nesh të jetë veç një vijë ndarëse që na takon për nga përkatësia politike por kurrësi një vijë ndarëse kur janë në pyetje interesat e qytetarëve që përfaqësojmë dhe projekte që synojmë t'i realizojmë për të mirën e këtij qyteti i cili meriton më të mirën.

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, në emër të Kryetarit të Komunës z.Shpejtim Bulliqi, po e paraqes propozim vendimin në fjalë lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi KKS dhe në kuadër të procesit të konstituimit të KKS-së në Komunën e Podujevës, duke u thirrur në Udhëzimin Administrativ 27/2012 për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi si dhe në bazë të ftesës publike për përbërjen e KKS-së në Komunën e Podujevës janë propozuar propozimet për plotësimin e anëtarëve të këtij Këshilli e që në shumicën e kategorive janë propozuar nga një përfaqësues të cilët në përputhje me dispozitat ligjore kalojnë me automatizëm për miratim mirëpo kemi 3 kategori që kemi nga dy kandidat që janë;

Përfaqësimi i etnive nga Komunitetet jo shumicë ku për përfaqësues të Komunitetit Ashkali janë sjellë propozimet Xhafer Ademi dhe Fitim Sejdiu, pastaj nga Mediat Lokale kemi propozimet Rozafat malokun dhe Rinit Veliun, si dhe Komuniteti i Bizneseve kemi propozimet Afrim Fazlija dhe Esad Kamerolli.

Sa i përket përfaqësimit të Komunitetit jo shumicë Egjiptas nuk kanë dërguar asnjë propozim, mirëpo në përputhje me nenin 10 pika 2 të Udhëzimit Administrativ të cekur, Kryetari i Komunës ose Nënkryetari për Komunitete në konsultim me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim propozojnë një individ nga Komunitetet përkatëse për të siguruar përfaqësim adekuat andaj në këtë rast Kryetari i Komunës ka propozuar znj.Sevdije Mustafa si përfaqësuese nga Komuniteti Egjiptas.

Tani unë mund t'i lexoj edhe emrat e anëtarëve tjerë të cilët shkojnë me automatizëm në kuadër të këtij Këshilli; është Kryetari i Komunës Shpejtim Bulliqi: Bashkim Bajrami Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë; Mensur Hoti përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë; Gjergj Uka përfaqësues i Kishës Protestante Ungjillore; përfaqësuesi i Komunitetit Ashkali do të votohet në vazhdim; Enver Rama përfaqësues i Komunitetit Rom; Sevdije Mustafa përfaqësuese e Komunitetit Egjiptian; pastaj është me automatizëm Kryesuesi/ja i/e Komitetit për Komunitete i cili në momentin e inaugurimit të këtij Komiteti dhe zgjedhje së tij do të inkorporohet në këtë Këshill; Naime Podvorica zyrtare për barazi gjinore; Avni Fetahu drejtor i Drejtorisë së Arsimit; Nazif Sheqa kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit; Ymerdin Hasani përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës; Qefser Behrami përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike; Naim Bajrami përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike; Granit Thaqi Ekipit Veprues për Siguri në

Bashkësi; Bahri Selimi përfaqësues i Emergjencave Civile; Liman Zeqiri përfaqësues i Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim; Sabrie Bislimi përfaqësues i OJQ-ve, dhe Idriz Hoxha përfaqësues i Komunitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara, ndërsa për pjesën tjetër i mbetet Kuvendit që paraprakisht t'i votoj të propozuarit që të jenë pjesë e përbërjes së këtij Këshilli, që janë përfaqësuesi i Komunitetit Ashkali, përfaqësuesi i Mediave Lokale, dhe përfaqësuesi i Komunitetit të Biznesit, të cilët janë nga dy propozime.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, e falënderoj parafolësin Nënkrjetarin e Komunës për paraqitjen e kësaj pike të rendit të ditës, andaj urdhëroni e hap diskutimin rreth kësaj pike.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, emrat dhe listën që e përmendi Nënkrjetari, unë kam 2-3 pika për t'i sqaruar. Te Këshilli i prindërve të arsimit Nazif Sheqa, nuk e dim ne, ose meqë është edhe drejtori i DKA-së këtu është mirë të na sqaroj se a ka mandat ai person apo nuk ka mandat, mandej te përfaqësuesi i Këshillit Lokal për Siguri Publike në Orllan ky drejtori i shkollës këtu duhet ta dimë se a është i certifikuar për siguri apo nuk është. Po ashtu te Udhëzimi Administrativ 27/2012 që e përmendi Nënkrjetari i cili e tregon përbërjen e KKSBB-së qysh themelohet dhe qysh bëhet, pika e fundit që është 1.14 thotë: një përfaqësues nga OJQ, mediat lokale, komuniteti i biznesit, dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara, kurse veç te kjo pikë këtu po del që janë një përfaqësues prej OJQ-ve, një prej mediave lokale, një prej komunitetit të bizneseve dhe një prej komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, e që po i bie se janë 5 persona, kurse këtu e thotë që duhet të zgjidhet një person. Pra në bazë të këtij Udhëzimi Administrativ që jeni thirrë ju këtu specifikohet shumë mirë, shembull pika 1.3 thotë nga një përfaqësues, por tek kjo pikë thotë një përfaqësues prej OJQ-ve, prej mediave lokale, prej komunitetit të bizneseve dhe prej komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, andaj nuk e di përse kjo kështu, këtu as nuk po paguhen dhe nuk e di përse e keni bërë gjithë këtë emër këtu, ose duhet që prej përfaqësuesit të OJQ-ve, prej mediave lokale, prej komunitetit të bizneseve dhe prej komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, të futet një në votim dhe të bëhet një prej tyre e jo me i shti gjithë këtë emër. Udhëzimi Administrativ nëse jeni thirr në këtë Udhëzim e thotë kështu, andaj shpresoj që do të merret parasysh kjo.

z.Fahri Restelica, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, të njëjtën çështje e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së një ditë më parë. Janë marrë praktikrat edhe të komunave tjera por gjithashtu edhe sipas informatave që kam marrë ka qenë praktikë edhe herave tjera që ato komunitete janë përfaqësuar me të njëjti përfaqësues, mirëpo edhe për një përfshirje sa më gjithëpërfshirëse në këtë Këshill, atëherë e kemi vendos që secila nga këto Komunitete ta ketë një përfaqësim, pra vetëm jo arsye është. Dhe shpresoj që të votohet kështu.

z.Abedin Zeka, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së ne e përkrahim këtë propozim vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

z.Besim Latifi, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së edhe ne e mbështesim këtë propozim vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Besojmë se është një organ i nevojshëm dhe do të na shërbej për çështje të sigurisë.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, atëherë ne i dëgjuam propozimet dhe diskutimet rreth kësaj pike nga anëtarët e Kuvendit dhe prezantimin nga Nënkrjetari i Komunës. Tani e kemi për obligim që paraprakisht t'i përzgjedhim edhe tre përfaqësues që janë nga dy kandidat të propozuar për përfaqësues të komuniteteve të ndryshme siç janë Komuniteti Ashkali, nga mediat lokale dhe nga Komuniteti i biznesit, prandaj do t'ju lusja që të votojmë dhe të përcaktohem për nga njërin prej tyre; pra fillojmë me të propozuarit nga Komuniteti Ashkali që janë Xhafer Ademi dhe Fitim Sejdiu, urdhëroni votojmë me ngritje dore sipas radhës.

-Pas votimit, u konstatua se nga 32 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, 12 vota ishin Për, asnjë votë Kundër, 13 vota të Përmbajtura, (të tjerët nuk votuan), që Xhafer Ademi të jetë anëtar i KKSB-së në cilësinë e përfaqësuesit të Komunitetit Ashkali.

-Pas votimit, u konstatua se nga 32 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, 18 vota ishin Për, asnjë votë Kundër, asnjë të Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan), që Fitim Sejdiu të jetë anëtar i KKSB-së në cilësinë e përfaqësuesit të Komunitetit Ashkali.

Konstatim:

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga dy propozimet e lartcekura për anëtar në kuadër të përbërjes së KKSB-së, z.Fitim Sejdiu ka marrë më shumë vota dhe rrjedhimisht do të jetë anëtar i këtij Këshilli në cilësinë e përfaqësuesit të Komunitetit Ashkali.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, tani kemi dy propozime për përfaqësues të Mediave Lokale që janë Rozafat Maloku-TV Llapi, dhe Rinit Veliu-Radio Vizioni, urdhëroni mund të votojmë edhe për këta me ngritje dore dhe atë sipas radhës.

-Pas votimit, u konstatua se nga 32 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, 30 vota ishin Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë e Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan), që Rozafat Maloku të jetë anëtar i KKSB-së në cilësinë e përfaqësuesit të Mediave Lokale.

-Pas votimit, u konstatua se nga 32 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, 8 vota ishin Për, asnjë votë Kundër, 18 vota të Përmbajtura, (të tjerët nuk votuan), që Rinit Veliu të jetë anëtar i KKSB-së në cilësinë e përfaqësuesit të Mediave Lokale.

Konstatim:

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga dy propozimet e lartcekura për anëtar në kuadër të përbërjes së KKSB-së, z.Rozafat Maloku ka marrë më shumë vota dhe rrjedhimisht do të jetë anëtar i këtij Këshilli në cilësinë e përfaqësuesit të Mediave Lokale.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, gjithashtu kemi edhe një votim për dy të propozuarit për përfaqësim nga Komuniteti i Biznesit që janë Afrim Fazlija-AMG NTP dhe Esad Kamerolli-Agnesa Sh.P.K, andaj urdhëroni edhe për këta mund të votojmë tani me ngritje dore, dhe atë sipas radhës.

-Pas votimit, u konstatua se nga 32 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, 19 vota ishin Për, 1 votë Kundër, asnjë votë e Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan), që Afrim Fazlija të jetë anëtar i KKSB-së në cilësinë e përfaqësuesit të Komunitetit të Biznesit.

-Pas votimit, u konstatua se nga 32 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, 12 vota ishin Për, asnjë votë Kundër, 10 vota të Përmbajtura, (të tjerët nuk votuan), që Esad Kamerolli të jetë anëtar i KKSB-së në cilësinë e përfaqësuesit të Komunitetit të Biznesit.

Konstatim:

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga dy propozimet e lartcekura për anëtar në kuadër të përbërjes së KKSB-së, z.Afrim Fazlija ka marrë më shumë vota dhe rrjedhimisht do të jetë anëtar i këtij Këshilli në cilësinë e përfaqësuesit të Komunitetit të Biznesit.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, tani e hedh në votim propozim vendimin në fjalë si tërësi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes me emrat përkatës të propozuar si dhe duke i'a bashkëngjitur konstatimet paraprake për tre emrat e votuar që të jenë përfaqësues të Komunitetit Ashkali që ishte Fitim Sejdiu, Mediave Lokale që ishte Rozafat Maloku, dhe Komunitetit të Biznesit që ishte Afrim Fazlija të cilët do të jenë pjesë e listës / përbërjes së anëtarëve të KKSB-së prej 21 përfaqësuesve sipas propozim vendimit përkatës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 32 anëtar/e të Kuvendit sa ishin të pranishëm, me 31 vota Për, asnjë Kundër, asnjë të Përmbajtur (1 anëtare nuk votoi), miratohet propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, sipas materialit dhe përbërjes përkatëse të propozuar dhe dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe konstatimet nga votimet paraprake, dhe atë me përbërjen e tërësishme si në vijim:

1. *Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, Kryesues*
2. *Bashkim Bajrami, Komandant i Stacionit të Policisë - në Podujevë*
3. *Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame - Podujevë*
4. *Gjergj Uka, përfaqësues i Kishës Protestante Ungjillore - Podujevë*
5. *Fitim Sejdiu, përfaqësues i Komunitetit Ashkali*
6. *Enver Rama, përfaqësues i komunitetit Rom*
7. *Sevdije Mustafa, përfaqësuese e komunitetit Egjiptian*
8. _____, *Kryesuesi/ja i/e Komitetit për Komunitete, i cili inkorporohet pas themelimit dhe inaugurimit të Komitetit për Komunitete, konform dispozitave përkatëse ligjore*
9. *Naime Podvorica, zyrtare për barazi gjinore*
10. *Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit*
11. *Nazif Sheqa, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit - Podujevë*
12. *Ymerdin Hasani, përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës - FSK*
13. *Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike - Kërpimëh*
14. *Naim Bajrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike - Orllan*
15. *Granit Thaqi, Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi*
16. *Bahri Selimi, përfaqësues i Emergjencave Civile*
17. *Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Podujevë*
18. *Sabrie Bislimi, përfaqësues i OJQ-ve,*
19. *Rozafat Maloku, përfaqësues i Mediave Lokale,*
20. *Afrim Fazlija, përfaqësues i Komunitetit të Biznesit*
21. *Idriz Hoxha, përfaqësues i Komunitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara*

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, duke i falënderuar për pjesëmarrjen kontributin dhe korrektësinë në këtë mbledhje, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45

**Procesverbalin e mbajti dhe hartoi;
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0011801/26
Podujevë,
26 shkurt 2026**

**Kryesuesi i Kuvendit
Isak Shabani**